

Sfidat e arsimimit të të rriturve në Kosovë

Venera Llunji*

Abstrakt

Shekulli 21 kërkon përpjekje serioze në të rishikuarit, zgjerimin, dhe pranimin në tërësi të nocionit të arsimimit të të rriturve. Arsimimi i të rriturve duhet t'i sigurojë secilit qasje në dije dhe mësimi gjatë gjithë jetës dhe në këtë mënyrë secilit t'i krijojë mundësi për të shijuar zhvillimin kulturor, social dhe ekonomik. Sot, të rriturit ballafaqohen me sfida të veçanta që nga zhvillimi i teknologjisë dhe zhvillimi shkencor e deri te kërkesat e shtuara të jetës së shpejtë sociale. Prandaj, qëllimi i këtij punimi është të kuptohet më mirë rëndësia që ka për të gjithë arsimimi për të rritur: për individët, për organizatat dhe për shoqëritë duke përfshirë edhe shoqërinë e Kosovës. Ky punim shqyrton sfidat e arsimimit të të rriturve me të cilat përballet Kosova si një shoqëri në tranzicion.

Çdo vit, mijëra të diplomuar hyjnë në tregun e punës. Ata përballen me sfida nga më të ndryshmet siç janë përshtatja në ambientet e reja, të mësuarit për t'i treguar aftësitë e reja dhe qëllimin e karrierës së tyre dhe përpjekjet për të krijuar një identitet të tyre profesional.

Me përsheptimin e ritmit të ndryshimeve në vendet e sotme të punës, është shtuar edhe nevoja për të krijuar mënyra të reja në përgatitjen e të punësuarve për t'i përmbushur këto sfida. Thënë ndryshe, shpërthimi në fushën e dijës dhe të teknologjisë informative kërkon që punonjësit të jenë të gatshëm dhe të aftë t'i ngërthejnë aftësitë dhe qasjet e reja. Të punësuarve u kërkohet të mësojnë vazhdimisht në vendet e tyre të punës në mënyrë që të sigurojnë vazhdimisht pjesëmarrjen e tyre. Shumë organizata e kanë inkurajuar mësimin e mëtejshëm si atë formal ashtu edhe mësimin joformal për të ndihmuar si organizatën ashtu edhe anëtarët e saj të përballen me ritmin e shpejtë të ndryshimeve. Kjo mënyrë e arsimimit po bëhet forcë e fuqishme në arsimin elementar dhe të vazhdueshëm të punonjësve të sotëm¹.

* Venera Llunji, PhD Cand. Universiteti AAB, Prishtinë, E-mail: venerallunji@hotmail.com

¹ Stephen Billet. *Learning in the workplace: Strategies for effective practice*. Australia: Allen & Unwin, 2001.

Prandaj, rëndësia e arsimimit të të rriturve për një zhvillim të gjithëmbarshëm ekonomik, social, dhe kulturor të shoqërisë tonë është bërë prioritet dhe çështje kryesore.

Fjalët kyç: *arsimimi i të rriturve, dija, të mësuarit, vendi i punës, zhvillimi, shoqëria*


Sfidat për arritjen e arsimimit për të rritur i përshtatshëm për të gjithë në Kosovë

Kosova përballlet me një sërë sfidash në arritjen e arsimit të përshtatshëm për të gjithë. Në eksplorimin e kësaj çështjeje, këto sfida janë kategorizuar si: ndryshimi, ekonomia, nxitja e një kulture të të mësuarit, dhe perspektivat e arsimimit të të rriturve.

Ndryshimi

Në mënyrë që të kuptojmë situatën aktuale arsimore në Kosovë, është e rëndësishme të reflektojmë në ish-sistemin arsimor në Kosovë dhe procesin e tij kalimtar. Para përpjekjeve serbe për dominimin politik dhe ushtarak në të gjitha republikat e Jugosllavisë dhe në veçanti në Kosovë gjatë viteve '90, të gjitha ish republikat e Jugosllavisë kishin një bazë të përbashkët të arsimit, edhe pse çdo republikë kishte të drejtë të siguronte ligjin e vet arsimor². Pavarësisht ngjashmërive në sistemin e arsimit nga republika në republikë, ka pasur edhe shumë dallime në gjuhë dhe kulturë e që kanë rezultuar me dallimet në programet shkollore. Megjithatë, struktura e përgjithshme e sistemeve shkollore ishte e njëjtë (shih tabelën në vijim).

² Polona Valencic, & Eva Vilfan. *Slovenian experience with certificates from Serbia and Kosovo, Fall 1999*. Marrë me 18 qershor, 2007, nga <http://www.aic.lv/ace/WP/Refugees/slovenia.htm>



Me fjalë të tjera, struktura e sistemit të arsimit ishte: 4 +4 +4 (klasat I-IV dhe V-VIII për shkollën fillore dhe I-IV të Shkollës së Mesme dhe duke përfshirë edhe Shkollën Teknike / Shkollat Profesionale). Arsimi i të rriturve si një prej forcave më të mëdha në zhvillimin dhe përmirësimin e përbushjes individuale dhe shoqërore për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik³ është realizuar nga universitetet e punëtorëve të cilat ofronin kurse të udhëhequra nga organizatat politike nën ideologjinë marksiste⁴ si dhe nga organizatat industriale e të tjera të organizuara për punonjësit e tyre. Ky ishte një sistem i:

- universiteteve popullore dhe universiteteve të punëtorëve në republikat më të zhvilluara të ish Jugosllavisë si në: Slloveni, Kroaci dhe Serbi;
- Shkollave të mbrëmjes dhe njësitë të arsimit të të rriturve në shkollat e rregullta dhe
- Qendrave arsimore në ndërmarrjet industriale dhe të tjera.

Shkolla e mbrëmjes, njësitë e arsimit të të rriturve, dhe qendrat arsimore në ndërmarrje ishin të hapura dhe funksionale në të gjitha republikat dhe krahinat e ish-Jugosllavisë. Në atë kohë, kishte, njësi respektivisht sektore brenda Fabrikave Industriale për Rindërtim,

³ Tzako Pantaleev. *Macedonia adult and continuing education*. Bonn: The Institute for International Cooperation of the German Adult Education Association, 2003.

⁴ Ana, Krajnc & Nives Licen. *Adult education in Slovenia*. Bonn: The Institute for International Cooperation of the German Adult Education Association, 2002.

dhe brenda Fabrikave tjerretore, si dhe brenda njësisve të shkollave të mesme të cilat ofronin kurse dhe trajnime për të rriturit në Kosovë.

Kosova u përball me vite të tëra me segregacion dhe diskriminim nën regjimin serb që rezultoi në heqjen e autonomisë së Kosovës dhe shtypjen e popullësisë shqiptare të Kosovës⁵. Si rezultat, sistemi arsimor i Kosovës ka vuajtur shumë me mungesën e mundësive për zhvillim të mëtejshëm dhe investime kapitale. Vitet ndërmjet 1991 dhe 1998 përfshijnë shkarkimin e të gjithë mësimdhënësve shqiptarë, imponimin e një kurrikule të unifikuar serbe nga autoritetet serbe që i detyroi mësimdhënësit shqiptarë, nxënës dhe studentë të themelojnë një sistem të vetë-financuar shkollimi të njohur si një sistem "paralel" i arsimit, me qëllim të ruajtjes së gjuhës dhe kulturës së vet. "Sistemin paralel" funksiononte në shtëpitë private, kishte administratën e vet të pavarur dhe financat e mbështetura nga shqiptarët që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit kryesisht në vendet evropiane dhe në SHBA. Kushtet e punës ishin të këqija, shtëpitë-shkolla ishin të pajisura keq dhe kishte rritje të largimit nga shkolla⁶, por mësimdhënësit dhe nxënësit ishin gjithsesi të motivuar për të mbajtur gjallë frymën e arsimit.

Represioni serb i cili zgjati nga viti 1991 deri në vitin 1999 dhe çoi në mbylljen totale të shkollave dhe universitetit me mësim në gjuhën shqipe, në një luftë, me rreth 1.000.000 shqiptarëve etnikë të dëbuar me forcë nga shtëpitë e tyre, bombardimet e NATO-s, tërheqja e ushtrisë jugosllave, e policisë dhe forcave dhe njësiteve paramilitare serbe, hyrja e KFOR-it në Kosovë dhe kthimi i refugjatëve shqiptarë⁷ ndryshuan rrjedhën e jetës në Kosovë dhe të popullsisë së saj. Me vendim të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Kosova u bë protektorat i OKB-së. Donatorët nga e gjithë bota ", filluan një


⁵ Gary Anderson & Anette Wenderoth. *Facilitating change: Reflection on six years of education development programming in challenging environments* (1st ed.) Montreal: Universal Management Group, 2007.

⁶ Po aty.

⁷Tunde Cerovic-Kovac, Carolin Leutloff, & Elmar Pichl. *Education and media in Southeast Europe: Country report on education, 2000*. Marrë me 18 qershor, 2007, nga http://www-gewi.uni-graz.at/csbsc/country_reports/Education_Kosovo.htm

program të ndihmës për zhvillim, e cila përkrahte shëndetin dhe arsimimin drejt ndërtimit të paqes"⁸. UNMIK-u i mandatoi organizatat ndërkombëtare qeveritare, të ashtuquajturat "Agjencitë Udhëheqëse", për të ndihmuar një proces kompleks të reformës së arsimit. Midis një numri të ndërkombëtareve, agjencive qeveritare dhe jo-qeveritare nga vende të ndryshme të botës, Canadian International Development Agency (CIDA) nisi projektin e saj më të madh (KEDP) duke ofruar ekspertizën dhe përsosmërinë e personelit të saj në fushën e arsimit.

Kjo dekadë e thyerjes arsimore dhe shtypjes në Kosovë kërkonte mbështetje të madhe ndërkombëtare dhe ristrukturim. Struktura vjetër e sistemit arsimor 4 + 4 + 4 u zëvendësua nga një strukturë e re 5 + 4 + 3 (4).



⁸ Gary Anderson & Anette Wenderoth. *Facilitating change: Reflection on six years of education development programming in challenging environments* (1st ed.) Montreal: Universal Management Group, 2006.

Klasa e 9-të e arsimit të detyrueshëm u bë një vit "orientimi" për t'ju siguruar nxënësve informacion dhe këshillim ashtu që të mund të zgjedhin zhvillimin e duhur personal, në aspektin e shkollimit të mëtejshëm dhe përfundimisht në shkollimin universitar, ose në drejtim të hyrjes në tregun e punës pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm.

Ekonomia dhe Punësimi

Zhvillimi global po ndikon jashtëzakonisht vendet, shoqëritë, tregjet, industrinë dhe mundësitë për punë në botë. Struktura të reja organizative dhe praktikat e reja të punës do të dalin në sipërfaqe që përfundimisht rezulton në interpretime të reja të mjediseve në vendin e punës. Këto ndryshime të reja kanë një ndikim të madh në njerëz dhe perspektivat e punësimit të tyre. Ato japin arsye reale dhe praktike për të inkorporuar arsimimin e të rriturve në infrastrukturën organizative. Kuptohet se aftësitë dhe njohuritë e mbështetura përmes programeve arsimore për të rriturit janë motorët e rritjes ekonomike dhe zhvillimit social të nevojshëm në Kosovë. Me një popullsi të llogaritur prej rreth 2.0 milion, nga e cila rreth 93% janë shqiptarë, 5% janë serbë, dhe 2% të tjerë, Kosova ka një bazë me një popullsi shumë të re që është konsideruar si resurs i mirë për zhvillimin e përgjithshëm të vendit.

| AGE | FEMALE % | MALE % | TOTAL % |
|--------------|------------|------------|------------|
| 0-14 | 30,8 | 33,8 | 32,3 |
| 15-64 | 62,2 | 60,2 | 61,2 |
| > 65 | 7,0 | 6,0 | 6,5 |
| Total | 100 | 100 | 100 |


Burimi: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e Kosovës, 2004

Megjithatë, Kosova renditet e fundit në Ballkan dhe është ndër shoqëritë më pak të zhvilluara në Europë⁹ me normat më të larta të papunësisë në Evropën Juglindore prej rreth 50%¹⁰ dhe me gati 26%

⁹ Human Development Report in Kosovo, 2004, f.1

¹⁰ CIA World Book Fact

të popullsisë së saj e cila jeton vetëm mbi kufirin e varfërisë. Zhvillimi ekonomik i Kosovës varet nga ndihma e donatorëve, ndihmës së diasporës dhe buxheti i Kosovës. Mungesa e statusit final të Kosovës deri në vitin 2008 u konsiderua si problem kryesor në parandalimin e rritjes ekonomike¹¹. Përkundër të gjitha vështirësive dhe sfidave gjatë këtyre viteve të përpjekjeve të përbashkëta dhe të planifikimit, institucionet e Kosovës së bashku me strukturat ndërkombëtare të pranishme në Kosovë, kanë ndërtuar një ambient të qëndrueshëm makroekonomik, kanë adoptuar euron si valutë, kanë ulur rreziqet e monedhës, kanë zgjeruar tatimin bazë të të ardhurave, kanë përmirësuar stabilitetin e përgjithshëm fiskal, si dhe kanë shkaktuar PBB të rritet, siç edhe tregohet në grafikun dhe tabelën më poshtë:



| ECONOMIC INDICATOR | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 |
|---------------------------------|-------|-------|-------|-------|
| GDP (MILLION EURO) | 1,625 | 1,735 | 1,795 | 1,895 |
| GDP PER CAPITA (EURO) | 870 | 913 | 930 | 964 |
| GDP GROWTH (%) | 0 | 1.2 | 3.1 | 3.2 |
| GNDI PER CAPITA (EURO) | 1,086 | 1,119 | 1,118 | 1,143 |
| INVESTMENT (MILLION EURO) | 40.7 | 34.5 | 29.3 | 27.8 |
| FOREIGN AID (MILLION EURO) | 1,144 | 902 | 732 | 624 |
| CONSUMER PRICE INDEX (% CHANGE) | - | 1.3 | 2.9 | 0.5 |

ECIKS / Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e Kosovës, 2004

¹¹ECIKS/ Ministry of Trade and Industry of Kosovo.

Që ekonomia e Kosovës është duke u përpjekur të marrë veten nga dëmet e regjimit të mëparshëm dhe pasojave të konfliktit, dhe është duke u përballur me tranzicionin drejt ekonomisë së tregut, zhvillimi i saj aktual varet nga njerëzit e saj, duke ndryshuar edhe formimin e shoqërisë në mënyrë që të gjithë të mund të përfitojnë. Megjithë rezultatet e arritura nga UNMIK-u dhe institucionet e Kosovës, status quo-ja politike e mbajtur për kaq shumë vite kishte shkaktuar pasiguri për investitorët e huaj për të investuar dhe si e tillë kishte shkaktuar parandalimin e rritjes reale ekonomike dhe zhvillimin e Kosovës.

Nxitja e kulturës së të mësuarit

Qendra për Hulumtime të Avancuara në Përvetësimin e Gjuhës e përkufizon kulturën si:

“modele të përbashkëta të sjelljes dhe ndërveprimit, ndërtim kognitiv dhe të kuptuarit afektiv që mësohen nëpërmjet një procesi të socializimit. Këto modele të përbashkëta identifikojnë anëtarët e një grupi kulturor, ndërsa dallojnë anëtarët e një grupi tjetër.”

Bazuar në përkufizimin e mësipërm, arsimit i të rriturve përfaqëson një mundësi të madhe për qeverinë -(të) për të përcaktuar vizionin e saj të një kulture të mësimit për të gjithë, duke mbështetur dhe promovuar politikat dhe iniciativat e tjera me një qëllim të qartë për të përmirësuar mundësitë për njerëzit e saj për të marrë pjesë në mësim dhe studim, punë dhe të tjera veprimtari në bazë të preferencave të tyre të ndryshme dhe prioriteteve: me fjalë të tjera për të mundësuar mësimin gjatë gjithë jetës, për të gjithë qytetarët e saj. Kështu, arsimit i të rriturve në Kosovë duhet të ofrojë mundësi për nxënësit e rritur për të forcuar njohuritë dhe aftësitë e tyre dhe për të përmirësuar jetën e tyre jo vetëm në institucionet e arsimit, por edhe në vendet e punës dhe / ose në qendrat e trajnimit. Kjo qasje mund të jetë e suksesshme vetëm kur kultura e të mësuarit brenda shoqërisë seriozisht ndryshon. Kur kjo ndodh, kontributi arsimor për një tablo më gjithëpërfshirëse për zhvillim të shoqërisë dhe qëndrueshmëri ekonomike do të bëhet i frytshëm. Ndryshimi kulturor ishte, është, dhe gjithmonë do të jetë një proces i ngadalshëm, i dhimbshëm dhe i vështirë për shkak se ai

lëkund plotësisht "rutinën" e një shoqërie, një organizate, dhe një individ deri në themelet e ciklit të tërë të jetesës, të mësuarit, dhe të punës. Të mësuarit gjatë gjithë jetës është thelbësor në tregun e punës, prandaj, vendet e punës janë thelbësore në mbështetjen, vlerësimin dhe zhvillimin e mundësive për të mësuar. Nëse kjo është të mësuarit në vazhdimësi në një vend pune, ajo ka nevojë për një bazë në kulturën e vendit të punës që e ushqen atë. Në organizatat e sotme moderne, duke përfshirë institucionet arsimore, punonjësit duhet të jenë të përgatitur për një rritje dhe zhvillim të vazhdueshëm. Duke marrë parasysh moshën e tyre, përvojën, jetesën, dhe kulturën, është e kuptueshme se praktikatat e arsimit të të rriturve duhet të lëvizin përtej modelit tradicional të mësuesit si siguroes të dijes dhe nxënësit si marrës pasiv. Kjo do të thotë se për të nxitur një kulturë të të mësuarit në shoqëritë e ndryshme, dallimet të të rriturit, dallimet e kulturave personale të nxënësve dhe edukatorëve dhe kulturat e mjedisit më të madh social-politik duhet të merren seriozisht në konsideratë. Në Kosovë, në krahasim me vendet e zhvilluara të OECD-së, imperativët ekonomikë janë më të fortë dhe më të rëndësishëm në nxitjen e një kulture të të mësuarit, edhe pse, për të mësuar gjatë gjithë jetës duhet të shkohet më tej se në përditësimin e njohurive për të përmirësuar produktivitetin dhe fuqinë e fituar individuale. Ai është gjithashtu një komponent i rëndësishëm i përfshirjes individuale dhe qytetarisë aktive. Megjithatë, të rriturit në Kosovë aktualisht nuk përfshihen në mundësitë e arsimimit të të rriturve ashtu si të rriturit në vendet e zhvilluara. Arsimi i të rriturve në Kosovë nuk është një nocion i ri në aspektin e arsimimit tradicional të të rriturve që u organizua në shkollat në mbrëmje dhe qendrat e trajnimit, në organizata dhe në ndërmarrje. Megjithatë, duke përdorur arsimimin për të rritur për zhvillimin e teknologjisë, qytetaria aktive dhe pjesëmarrja e plotë në shoqëri është një qasje dhe filozofi e re për Kosovën. Për shkak të rritjes së stabilitetit politik dhe ekonomik, Kosova tani është në një pozitë për të krijuar një sistem arsimor të të rriturve të organizuar mirë, të cilët mund të punojnë në mënyrë aktive për të përfituar për shoqërinë e vet. Dëshmi nga vendet tjera tregojnë se një sistem i fortë arsimimi për të rriturit gjeneron një popullsi të arsimuar mirë dhe kompetente, pjesëmarrje të lartë në punët e komunitetit, norma të

larta të pjesëmarrjes së fuqisë punëtore, dhe standarde të larta të jetesës¹². Kjo qasje e re është e nevojshme për sistemin arsimor të Kosovës, nëse vendi dëshiron të korrë përfitimet e para në vende të tjera.

Perspektiva e Arsimit të të Rriturve

Arsimi i të rriturve praktikohet në të gjithë botën dhe dallon në filozofi, fushëveprim, dhe strukturë. Si i tillë, një numër i perspektivave për arsimin e të rriturve janë evidente në literaturën ndërkombëtare. Knowles (1988) përshkruan edukimin e të rriturve mbi bazën e tre fenomeneve: (a) si një sërë aktiviteteve të individëve dhe një numër të programeve të ofruara nga institucionet, (b) si proces intelektual i të rriturve në të mësuarit, dhe (c) si sistem shoqëror ", i cili është i përbërë nga individë dhe organizata që merren me arsimimin e të rriturve"¹³. Meqë njerëzit ndikojnë në ndryshime ekonomike, industriale, teknologjike, shkencore dhe kulturore, si dhe i përgjigjen të njëjtës, ata kanë nevojë për njohuri, kapacitetet, aftësi dhe perspektiva të ardhshme. Meqë këta faktorë do t'u mundësojë atyre të kenë zgjedhje për ta, të kenë mundësi të reja për të udhëhequr dhe kontrolluar jetën e tyre, familjen, punën, komunitetin dhe shoqërinë në përgjithësi, atëherë zhvillimi profesional, social, rekreativ dhe vetë-zhvillimi janë përcaktuar si katër kategori të arsimimit të të rriturve¹⁴.

Human Manifesto (Manifesti Njerëzor) I dhe II nënkupton që:

"kërkesa për jetë të mirë është ende detyrë qendrore e njerëzimit. Njeriu më në fund po bëhet i vetëdijshëm se ai është përgjegjësi i vetëm për realizimin e botës së ëndrrave të tij; se ai ka brenda vetes fuqinë për arritjen e saj. Ai duhet ta përdorë inteligjencën dhe vullnetin për ta përmbushur

¹² OECD. *The Knowledge-based economy*, 1996.

¹³ Gordon Selman, Michael Cooke, Mark Selman, & Paul Dampier. *The foundations of adult education* (2nd ed.). Toronto: Thompson Educational Publishing, Inc., 1998. 15

¹⁴ Selman et al. *The foundations of adult education* (2nd ed.). Toronto: Thompson Educational Publishing, Inc. (1998).

detyrën"¹⁵ Gjithashtu Anderson dhe Humick theksuan se "gatishmëria e të gjithë partnerëve për t'u angazhuar në tranzicion është e domosdoshme"¹⁶, pastaj, një qasje e tillë duhet të merret në konsideratë kur të pranohet arsimi i të rriturve si i domosdoshëm për të gjithë. Ata që përfshihen në arsimin e të rriturve e përshkruajnë atë si praktikë e mësimdhënies dhe edukimit të të rriturve kryesisht në vendin e punës ose nëpërmjet të arsimimit të vazhdueshëm në shkolla të mesme, kolegje, universitete ose me një qëllim dhe një shpresë të arsyeshme, që njohuritë e reja do t'i ndihmojnë ata në zhvillimin e mëtejshëm të qëllimit të tyre.¹⁷

Arsimi i të rriturve në pothuajse të gjitha shoqëritë në botë është:

*"një ndërmarrje marginale e sponsorizuar nga organizatat, qëllimi dhe objektivi kryesor i të cilës qëndron diku tjetër. Në shumicën e parametrave të tij, edukimi i të rriturve është parë të jetë një mjet për të përfunduar diçka dhe jo si një qëllim në vetvete. Qëllimi shpeshherë nuk nënkupton funksionim më të plotë të njerëzve, si të tillë, por punëtorë më produktiv, praktikues me më shumë ekspertizë, qytetarë më të informuar dhe - ndoshta klientë më institucional."*¹⁸

Për shkak të një përshkrimi të tillë, arsimi i të rriturve kryesisht reflekton mbi karakteristikat e shoqërisë në të cilën ajo është e organizuar, e zhvilluar dhe e mbështetur dhe "në të cilin ajo vepron".¹⁹ Në Kosovë, qasja në dije dhe mësim gjatë gjithë jetës është një nga sfidat më të mëdha dhe më serioze siç janë edhe kushtet dhe mundësitë në luftimin e varfërisë që është përmbi 30%, në zvogëlimin e normës së papunësisë që arrin mbi 50%, dhe në mundësitë për përfshirje sociale. Varfëria, përjashtimi social dhe mungesa e mundësive më të mira në jetë, në arsim dhe punësim, përbëjnë një

¹⁵ John Ellias, & Sharan Merriem. *Philosophical foundations of adult education*(3rd ed.). Florida: Krieger Publishing Company,2005. f.117- 118

¹⁶ Gary Anderson, & Anette Wenderoth. *Facilitating change: Reflection on six years of education development programming in challenging environments* (1st ed.) Montreal: Universal Management Group,2007 f.61

¹⁷ Adult Education-Wikipedia, the free encyclopedia

¹⁸ Selman, et al. *The foundations of adult education* (2nd ed.). Toronto: Thompson Educational Publishing, Inc.,1998, f.33

¹⁹ Po aty, f.33

kërcënim për stabilitetin e shoqërisë kosovare. Komiteti i nënkancelarëve dhe i drejtorëve të Mbretërisë së Bashkuar (1996) deklaroi se *“kohezionin social ku një ndjenjë e solidaritetit dhe interesit të përbashkët lidh një shoqëri të shëndoshë është nxitur më së miri nga arsimimi. Me rritjen e fuqisë ekonomike dhe fuqisë së aftë punëtore, të paarsimuarit do të ngelen edhe më pas se që janë tani. Ne nuk mund të rrezikojmë rritjen e hendekut midis atyre me aftësi të larta, dhe atyre me aftësi të ulët-ose pa asnjë aftësi fare. Të paarsimuarit do të mbesin të pakënaqur dhe pa të drejta. Arsimimi nuk është i lirë, por injoranca bart kosto edhe më të lartë sociale dhe ekonomike”*²⁰.

Në arsimin e të rriturve, duhet të merret në konsideratë një ndërgjegjësim më i gjerë i nevojave të nxënësit, qofshin ato të lidhura me punën, jetën kulturore apo personale, sepse të mësuarit do të ndikojë në njohuritë e tyre dhe zhvillimin profesional dhe do t'i bëjë njerëzit të reflektojnë mbi plotësimin e nevojave të tyre dhe ato të shoqërisë së tyre. Me fjalë të tjera, me arsimimin e të rriturve përfiton jo vetëm individi, por në një periudhë afatgjate përparon edhe shoqëria si e tërë.

Me qëllim të lëvizjes së përbashkët me vendet e tjera dhe shoqëritë e botës, Kosova është duke u përpjekur seriozisht për zhvillimin e arsimit të të rriturve si një komponent kyç për rigjenerimin ekonomik dhe social. Si një anëtare e shoqërive në tranzicion në Evropën Juglindore, Kosova do të duhet ta përdorë edukimin si një mjet për zgjidhjen e problemeve ekonomike me të cilat po përballon popullsia e saj. Si rezultat, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, u bë palë nënshkruese e Deklaratës Mesdhetare për Mësim Gjatë Gjithë Jetës, në Maqedoni në vitin 2003 e cila:

“siguron që arsimi i të rriturve dhe trajnimi profesional të bëhen pjesë integrale dhe e qartë e politikave dhe praktikave të të nxënësve gjatë gjithë jetës; mbështet krijimin e kuadrit të nevojshëm ligjor dhe mekanizmat e duhur; siguron mbështetje adekuate financiare për arsimin e të rriturve dhe zhvillimin e qëndrueshëm të formimit profesional; nxit partneritetin midis organizmave të ndryshëm me qëllim të adresimit të nevojave të ndryshme të

²⁰ The Committee of Vice-Chancellors and Principals of the United Kingdom, 1996

mësimin për të rritur dhe për të nxitur pjesëmarrjen aktive në shoqëri; siguron dhe promovon mundësitë e barabarta dhe qasje në arsim cilësor për pakicat etnike dhe grupet shoqërore të pafavorizuara, rrit aplikimin e politikave të ndjeshme gjinore në ofrimin e arsimimit të të rriturve; mbështet zhvillimin e cilësisë dhe certifikimin e arsimimit të të rriturve dhe programeve të trajnimit profesional në njohjen e mësimin të të rriturve, mësimin formal dhe jo-formal; koordinon arsimin për të rritur dhe aktivitetet e trajnimit profesional në mënyrë që të zhvillojë sektorin i cili do të marrë parasysh nevojat sociale dhe politike për të nxënëit gjatë gjithë jetës; krijon një sistem për njohjen e kualifikimeve ekzistuese dhe atyre të sapo dalura, diplomave dhe certifikatave në të gjithë Evropën, brenda dhe përtej kufijve kombëtarë / territorial, duke përmirësuar transparencën dhe mbështetjen e zhvillimit të aftësive dhe kualifikimeve; përfshin arsimin e të rriturve, si një pjesë e rëndësishme e trajnimit të mësuesve”²¹.

Pengesat në realizimin e Arsimimit Për Të Rritur dhe arsimimit gjithëpërfshirës në Kosovë

Janë një sërë pengesash që dalin në përmbushjen e arsimimit të të rriturve dhe atij gjithëpërfshirës në Kosovë.

Identifikimi i pengesave

Arsimimi i të rriturve është i njohur dhe i mbrojtur në mënyra të ndryshme në legjislacione të ndryshme të vendeve të ndryshme. Pjesëmarrja në arsimimin e të rriturve mbetet shumë e pabarabartë, sepse ata që janë më në nevojë kanë tendencë të kenë më pak mundësi për të marrë pjesë. Meqë filozofia themelore e arsimimit të të rriturve qëndron në ndërtimin e kapitalit shoqëror, nxitjen e përfshirjes sociale dhe luftimin e shpenzimeve qofshin ato të drejtpërdrejta dhe më pak të dukshme të përjashtimit social, shpeshherë pengesat që qëndrojnë

²¹ IIZ/DVV. *Mediterranean conference on lifelong learning declaration, 2003., 2004, fq.1-3*

në rrugën për të siguruar mundësitë e duhura dhe të nevojshme për arsimimin e të rriturve dhe për të krijuar një kulturë të të mësuarit, janë të pranishme. Këto pengesa duhet të kundërshtohen me seriozitet dhe të minimizohen në mënyrë që të mundësojnë zhvillimin e duhur të arsimimit të të rriturve. Pengesat ndryshojnë nga vendi në vend dhe shkojnë nga ato të thjeshta e deri tek ato komplekse, e Kosova ka disa pengesa për të kapërcyer.

Në vendet e zhvilluara të Evropës, pengesat dhe barrierat ndryshojnë nga ato në vendet më pak të zhvilluara dhe vendeve në tranzicion. Ndërsa pengesa kryesore për nxitjen e arsimimit të të rriturve në vendet e zhvilluara mund të përfshijnë mungesën e kohës, të hollat, ofertat e duhura arsimore, familjen jo përkrahëse, mungesën e kulturës, përvojën jo të mirë gjatë periudhës së mëhershme të të nxënies, dhe dështimi për të kuptuar të mirat e të mësuarit dhe nxënies, arsimimi për të rriturit në Kosovë ballafaqohet me të gjitha ato që u përmendën më lartë dhe më shumë²². Për më tepër, arsimimi i të rriturve në Kosovë përballet me korniza ligjore jo aq të qëndrueshme, i mungon dialogu social, dhe i mungon një traditë në mesin e ndërmarrjeve që do të investonin në zhvillimin e resurseve njerëzore. Arsimi për të rriturit ndeshet me motivim të pamjaftueshëm për ata që janë në punë e të cilët duan të përmirësojnë kualifikimet e tyre, rrjeti i infrastrukturës dhe personelit për arsimimin e të rriturve është i pamjaftueshëm, ka edhe mospërputhje midis përmbajtjes së arsimit të të rriturve dhe nevojave sociale dhe atyre të tregut të punës, dhe mundësitë për investime dhe për veprimtaritë kërkimore janë të kufizuara.

Motivimi

Ekziston një literaturë e kufizuar mbi arsimin e të rriturve e cila në mënyrë specifike adreson pyetjen se si duhet motivuar të rriturit për të marrë pjesë dhe për të përfunduar arsimin e organizuar mëtej. Qasja e njohur kognitive e Frederic Herzbergut, mbi motivimin, e njohur si

²² Adult Education Trends and Issues in Europe. *Trends in Participation- Access and Social Inclusion*, 2003

qasja e "-bukës dhe kërrbaçit" shpjegon se "edhe pse njerëzit mund të kontrollohen nga forcat e jashtme siç janë shpërblimet dhe ndëshkimet, një faktor i rëndësishëm në motivimin e njerëzve qëndron brenda vetë individëve"²³, përderisa perspektiva humaniste shpjegon "se nevojat personale vazhdimisht rriten dhe zhvillohen, duke kultivuar vetëbesimin individual, dhe duke plotësuar kështu marrëdhëniet njerëzore e që konsiderohet si nxitës shumë motivues"²⁴; poashtu "motivimi i njerëzve nuk është një çështje e thjeshtë dhe as nuk mund të shikohet si çështje e thjeshtë, dhe sigurisht as si procedurë mekanike, ose grup procedurash të thjeshta"²⁵.

Motivimi, pra, është një pengesë e madhe në krijimin e infrastrukturës së domosdoshme për arsimimin e të rriturve në shkallën e cila do të mbështeste si zhvillimin shoqëror ashtu edhe atë personal. Edhe pse mbi 90% e të rriturve thonë se arsimimi i ndihmon individët dhe vendit në përgjithësi, mospjesëmarrja e të rriturve në mësim flet se arsimimi i të rriturve nuk është zgjedhje tërheqëse për shumë të rritur. Motivimi si pengesë është një çështje që duhet të konsiderohet çështje serioze nga palët përgjegjëse siç janë qeveritë, industritë dhe organizatat, me qëllim të nxitjes, inkurajimit dhe bindjes tek të rriturit për lidhjen e drejtpërdrejtë në mes të mësimin dhe mirëqenies personale. Duke marrë pjesë në arsimimin e të rriturve, të rriturit mund të zhvillojnë nevojat e tyre individuale, aspiratat, vetë-besimin, vetë-përcaktimin dhe vetë-respektin. Avancimi i mëtejshëm nëpërmjet arritjes personale dhe profesionale, të siguruar nga arsimimi i të rriturve, është faktor i motivimit i lidhur me organizatat dhe ndërmarrjet. Këto kontekste kanë bërë të mundur qasjen dhe arritjet për të mirën, sukseset, dhe promovimin e organizatës dhe individit. Nëse dikush mendon se qëllimi kryesor i arsimimit të të rriturve është zakonisht i bazuar në një aktivitet vullnetar të individëve që kërkojnë të mësojnë duke u bazuar në

²³ Robert G. Owens. *Organizational behavior in education: Adaptive leadership and school reform* (8th ed.). USA: Pearson education, Inc., 2004. f.369

²⁴ Po aty. f.369

²⁵ Po aty. f.381

interesin e tyre,²⁶ duhet thënë poashtu se arsimimi për të rritur çon në emancipimin, iluminizmin dhe fuqizimin, i cili është më se i përhapur në botën e zhvilluar bashkëkohore, ngase mos-pjesëmarrja në arsimimin e të rriturve do të thotë marginalizim social dhe ekonomik. Ky kompleksitet është rritur edhe më shumë nga realiteti se arsimi për të rritur nënkupton përmbushjen e nevojave jo vetëm të komuniteteve me gjendje të pandryshuar por edhe të komuniteteve të marginalizuara siç janë njerëzit me aftësi të kufizuara, grupet e pakicave etnike, femrat kryesisht në zonat rurale dhe atyre që nuk kanë kualifikim pavarësisht nga mosha e popullsisë së tyre, qoftë ajo e re apo e shtyer.

Zbatimi i Arsimimit të të Rriturve dhe Gjithëpërfshirës në Kosovë

Qëllimi i edukimit është pasurimi i vetë jetës: ai kontribuon në cilësinë e tërë jetës. Kombet që janë ekonomikisht të suksesshme do të jenë ato që do të bëhen shoqëri e të mësuarit: të gjithë jemi të përkushtuar që përmes edukimit dhe trajnimit efektiv të mësojmë gjatë gjithë jetës. Pra, që të jemi një komb i suksesshëm në një botë konkurruese, dhe të mund të ruajmë një shoqëri kohezive dhe një kulturë të pasur, ne duhet të investojmë në edukim me qëllim të zhvillimit të resursit tonë më të madh, pra të popullit tonë²⁷.

Zbatimi i arsimimit të të rriturve në Kosovë do të kërkojë angazhimin serioz të qeverisë, bashkëpunëtorëve kyç, dhe të industrisë me qëllim të koordinimit të përpjekjeve të tyre.

Qeveria

Shoqëria kosovare kërkon përparim. Prandaj qëllimi themelor i qeverisë së saj është të zhvillojë një sistem koherent të arsimit gjatë gjithë jetës. Kjo do të thotë se përgjegjësia e Qeverisë është që të

²⁶ Malcolm Knowles. *Self-directed learning: A guide for learners and teachers*. New York: Cambridge Book Co.,1998

²⁷ National Committee of Inquiry into Higher Education in the United Kingdom,1977

ndërtojë një sistem të arsimit, në të cilën shkollat, kolegjet, universitetet, vendet e punës dhe komuniteti përqafojnë dhe mbështesin politikat arsimore dhe iniciativat që promovojnë arsimin dhe edukimin e të rriturve në veçanti. Roli i saj thelbësor është në promovimin e pjesëmarrjes më të madhe të komunitetit, promovimin e barazisë sociale, dhe të një shoqërie gjithëpërfshirëse. Me fjalë të tjera, roli i saj është promovimi i të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe për të gjithë individët e shoqërisë, përmirësimi i cilësisë, dhe qasja në sistemin arsimor në Kosovë; përputhja e sistemit arsimor në Kosovë me standardet e BE-së; integrimi i të gjithë fëmijëve në arsimim të detyrueshëm nga mosha 6 deri në 15, dhe inkurajim në zhvillimin e komunitetit shkencor si një treg shumë i kualifikuar për inovacionet dhe zhvillimin e një sistemi gjithëpërfshirës të arsimit të lartë. Ministria është përgjegjëse edhe për promovimin e një sistemi të vetëm, të unifikuar, dhe gjithëpërfshirës arsimor në mënyrë që e drejta e secilit person për arsim të jetë respektuar. Gjithashtu të ofrojë mundësi të të nxëniet cilësor dhe në dispozicion për të gjithë, pavarësisht nga origjina e tyre etnike apo sociale, raca, gjinia, paaftësia, feja, politika, ose mendimi apo opinioni ndryshe.

Arsimi i të rriturve është bërë një pjesë shumë e rëndësishme e arsimit në përgjithësi, dhe për zbatimin e tij, Ministria e Arsimit nuk mund të jetë lojtar i vetëm. Përkundrazi ajo ka për të punuar në partneritetet me ministrinë tjera që gjithashtu luajnë një rol në arsimin e të rriturve dhe arsimin gjatë tërë jetës si:

- Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, e cila me anë të politikave të saj kulturore punon në drejtim të rritjes së demokratizimit të shoqërisë, ofron aktivitete kulturore për të rinjtë e Kosovës, aktivitete të ndryshme në ngritjen e vetëdijes mbi çështjet si: sjellja e të rinjve në shoqëritë kalimtare, rreziqet me të cilat mund të përballen rinia në Kosovë, si: abuzim të drogës, HIV / AIDS, dhe trafikim, të cilat nuk kanë qenë pjesë e shoqërisë së Kosovës deri pas luftës së fundit;

- Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, e cila ofron formim profesional me qëllim të përmirësimit të punësimit të të papunëve të regjistruar, përmes përditësimit të njohurive dhe shkathtësive të nevojshme për tregun e punës në disa fusha të profesionit. Në

krahasim me arsimin profesional klasik, i cili është nën përgjegjësinë e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, trajnimi profesional i ofruar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përdor metodat e arsimit të të rriturve, dhe tenton të jetë me orientim më afatshkurtër, duke synuar konkretisht riintegrimin e të papunëve në punësim brenda një periudhe të caktuar kohore pas trajnimit;

- Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, e cila bashkëpunon me ministritë e tjera duke ofruar të dhëna për zhvillimin e tregtisë dhe industrisë dhe duke krijuar mundësi për të rriturit për të siguruar vende të punës dhe duke reduktuar kështu shkallën e lartë të papunësisë.

Qeveria gjithashtu duhet të punojë në partneritet me aktorë të tjerë që përfaqësojnë organizatat ndërkombëtare dhe kombëtare, qeveritare dhe jo-qeveritare, si: GTZ, KOSVET, Swiss Contact, AGEF, dhe Agjencia Evropiane për Rindërtim. Ajo duhet të bashkëpunojë ngushtë me Bankën Botërore dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar, në mënyrë që të planifikojë dhe koordinojë buxhetin e siguruar për zhvillimin e arsimit.

Roli i aktorëve

Në mënyrë që të përmbushen sfidat që Ministria e Arsimit (MASHT) i ka në ofrimin e arsimit gjithëpërfshirës dhe sidomos me synim zhvillimin e arsimit të të rriturve dhe të të nxëniet gjatë gjithë jetës, është e rëndësishme që të bashkëpunohet me të gjithë partnerët e interesuar si në sektorin privat ashtu dhe atë publik.

Për shembull, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, organizatat qeveritare gjermane GTZ dhe AGEF, organizata qeveritare zvicerane Swiss Contact, dhe organizatat kombëtare të tilla si KOSVET, Riinvest, shoqata KAEA, qendra e trajnimit "Smart Bits", Qendra e Trajnimit "Don Bosco", Qendra Për Arsim e Kosovës (KEC), dhe organizata kanadeze CIDA / KEDP, janë organizata që kanë kontribuar dhe ende kontribuojnë në arsimimin dhe trajnimin e të rriturve, duke u siguruar se qasja është në dispozicion edhe për qytetarët e margjinalizuar dhe qytetarët në përgjithësi. Ata ishin

partnerë të ngushtë në hartimin e Strategjisë për Arsimimin e dhe Trajnimin e Rriturve të Kosovës.

Vendi i Punës

Mendimi i institucioneve të Kosovës, i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, si dhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është se arsimi në Kosovë në përgjithësi i kushton më shumë vëmendje njohurive teorike dhe më pak njohurive për zhvillimin e njohurive praktike që mund të zbatohet në punësim dhe për jetë. Kapaciteti i shkollave profesionale është ende i ulët në drejtim të përgatitjes për punësim për shkak të mungesës së infrastrukturës dhe mungesës së fondeve të mjaftueshme për zhvillimin e saj të qëndrueshëm. Është vetëm një numër i vogël i shkollave profesionale të cilat ofrojnë një trajnim të duhur për shkak se ato shkolla janë të mbështetura zakonisht nga donatorët ndërkombëtarë si GTZ dhe Swiss Contact. Në Kosovë ende mungojnë masat për të nxitur edukimin e të rriturve në organizatat dhe ndërmarrjet për shkak të mungesës së dialogut social. Nuk ka traditë në mesin e ndërmarrjeve që të investojnë në zhvillimin e resurseve njerëzore. Ka paqartësi mbi rolin e arsimit të të rriturve në shoqëri. Ka mungesë të një sistemi të përgjithshëm të kontrollit të cilësisë, vlerësimit, dhe certifikimit të kualifikimeve në sistemin arsimor dhe të trajnimit.

Të rriturit kosovarë kanë shumë mundësi për të mësuar. Ata mësojnë për t'u përgatitur për punë, dhe mësojnë për të bërë punë, ata gjithashtu mësojnë për t'u përballur me ndryshimet në punë dhe mësojnë shumë gjëra në mjediset e punës që mund të kontribuojnë për jetën e tyre, të familjeve të tyre dhe të komuniteteve²⁸. Kjo do të thotë se institucionet arsimore nuk mund të jenë vendet kryesore në të cilat nxënësit arrijnë nivelin e njohurive dhe përvojën për punë. Brenda kontekstit të të mësuarit gjatë gjithë jetës, ekziston një marrëdhënie simbiotike mes punës dhe mësimi dhe kështu vendi i punës

²⁸ David Boud. *Current issues and new agendas in workplace learning*. Australia: NCVER Ltd.,1998

shndërrohet në një mjedis dinamik ku të mësuarit edhe ndodh. Megjithatë, edhe sot, në një numër të shoqërive, duke përfshirë Kosovën, vendi i punës është vendi ku vihet në praktikë teoria e shkollës ose e universitetit. Për fat të keq, një qasje e tillë nuk është më e mjaftueshme dhe nuk nxit zhvillimin e organizatës në një nivel që do të sigurojë zhvillim të vazhdueshëm dhe madje edhe ta mbështesë këtë organizatë. Duke ndryshuar kulturën e një organizate në atë mënyrë që të rriturit si individ i është dhënë një mjedis i cili kontribuon më tej në zgjerimin e njohurive, shkathtësive dhe kapaciteteve, organizata siguron një nivel të lartë të efikasitetit dhe efektivitetit dhe pa asnjë dyshim, siguron rezultatet më të mira, ose siç ka thënë Zuboff (1988):

Organizata [vërtetë e suksesshme] është një institucion i të mësuarit, dhe një nga qëllimet kryesore të saj është zgjerimi i diturisë. Mësimi nuk është më një aktivitet i veçantë që ndodh para ose pasi që një njeri hyn në vendin e punës ose në mjedise të klasës. Ajo nuk është as aktivitet i cili ruhet për një grup menaxherial ... Thënë thjeshtë, të mësuarit është formë e re e punës²⁹.

Krahasuar me vendet e tjera që e kanë kuptuar rëndësinë e arsimimit të të rriturve dhe janë duke u përpjekur për të krijuar mjedise mësimore për punonjësit e tyre, Kosova e karakterizon veten me dy grupet e organizatave që "kujdeset" për punonjësit e tyre: Organizatat ndërkombëtare dhe organizatat lokale.

Organizatat ndërkombëtare ofrojnë një mjedis ku të rriturit kanë mundësi të vazhdueshme të të mësuarit, ku hulumtimi dhe dialogu janë promovuar, ku bashkëpunimi dhe të mësuarit në ekip janë të inkurajuar, dhe ku ata janë fuqizuar drejt një vizioni kolektiv dhe gjithmonë lidhen qëllimet e organizatës, vizionet dhe planet me nevojat dhe përfitimet e komunitetit³⁰. Organizatat lokale janë më të shqetësuara për të mësuarit/të nxënit për vendin e punës sesa të

²⁹ Shoshana Zuboff. *In the age of the smart machine: The future of work and power*. New York: Basic Books.,1998 f.395

³⁰ KarenWatkins & Victoria Marsick. *Building the learning organization: A new role for human resource developers*. *Studies in continuing education*,1992 Vol.14 No 2, 29-115.

mësuarit/të nxëniet në vendin e punës³¹. Vendet e punës tani duhet të jenë të dizajnuara në mënyrë të tillë që të zhvillojnë cilësinë dhe produktivitetin, përshtatshmërinë dhe besueshmërinë, risinë dhe përmirësimin, si dhe mësimnxënien e përbashkët në mënyrë që të ndajnë përfitimet e veta me individin, organizatën dhe shoqërinë.

Përmbledhje dhe Përfundim

Humanisti ka bindjen se në përkrahjen ndaj individit, përfiton shoqëria. Megjithatë, shoqëria kosovare nuk i kushton rëndësi të mjaftueshme arsimit të të rriturve. Institucionet e saj, organizatat dhe individët duhet të jenë më shumë të përfshirë në të, në mënyrë që të përshtaten me ritmin e shpejtë të ndryshimeve në shoqërinë tonë e cila ka tendencë të jetë një shoqëri e dijes, e integruar në rrjedhat e proceseve evropiane, duke ofruar mundësi të barabarta për zhvillimin personal të të gjithë individëve, të cilët në këmbim do të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror. Presioni nga kërkesat e tregut të punës, shkalla e lartë e papunësisë, forca e punës me një përqindje relativisht të lartë të shkathësive të pakëta, grupet e pafavorizuara në tregun e punës, si dhe pabarazia rajonale në zhvillim, kërkojnë një qasje serioze të të gjithë aktorëve të arsimit në mbështetjen të arsimit për të rritur. Prandaj, arsimitimi i të rriturve në Kosovë është një përgjegjësi e ndarë tek lojtarë të ndryshëm. Ai është një mjet për të luftuar varfërinë dhe përjashtimin social, duke marrë pjesë në zhvillimin rajonal, duke promovuar integrimin socio-ekonomik të segmenteve të popullsisë me vështirësi të veçanta dhe duke kontribuar në vitalitetin kulturor të Kosovës. Të bindur se arsimitimi i të rriturve mund të kontribuojë në zhvillimin ekonomik dhe kulturor, zhvillimin individual dhe shoqëror dhe progres të gjithëmbarshtëm, një parakusht për zhvillimin e tij është vullneti dhe përcaktimi i aktorëve në partneritet, duke marrë pjesë në nivelin kombëtar, rajonal dhe lokal. Me këtë sfond, Qeveria, Ministria e

³¹ Sue Berryman. *Learning for the workplace. Review of Research in Education*,1993, Vol.19, 343-401.

Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, partnerët ndërkombëtarë dhe vendor, universitetet dhe institucionet e tjera arsimore duhet të punojnë krah për krah për të zhvilluar një strategji kombëtare për arsimimin e të rriturve. Ata gjithashtu duhet të zhvillojnë një plan kombëtar veprimi për zbatimin e arsimimit të të rriturve, duhet të zhvillojnë një plan kombëtar dhe një strategji për zhvillimin e resurseve njerezore, dhe të sigurojnë të dhëna të sakta dhe gjithëpërfshirëse në lidhje me qasjen dhe të drejtën ndaj edukimit dhe tregut të punës. Siç kishte thënë Martin Luther King, Jr : "*ne mund të kemi ardhur të gjithë me anije të ndryshme, por tani jemi në të njëjtën barkë*"³². Ne mund ta arrijmë këtë synim arsimor në Kosovë, sepse Kosova është ballafaquar me sfida të ngjashme edhe më parë. Por, ne duam ta bëjmë këtë mirë dhe e kemi forcën për të bërë gjithçka që është e nevojshme.

Bibliografia

Adult Education Trends and Issues in Europe. *Trends in Participation-Access and Social Inclusion*. Retrieved on May 17, 2007, from <http://www.eaea.org/doc/eaea/AET/studyfinal.doc>

Anderson, Gary. & Wenderoth, Anette. *Facilitating change: Reflection on six years of education development programming in challenging environments* (1st ed.) Montreal: Universal Management Group, 2007.
Bain, Ken. *What the best college teachers do*. London: Harvard University Press, 2004.

Berryman, Sue. *Learning for the workplace. Review of Research in Education*, 1993: Vol.19, 343-401.

Billet, Stephen. *Learning in the workplace: Strategies for effective practice*. Australia: Allen & Unwin, 2001.

Boud, David. *Current issues and new agendas in workplace learning*. Australia: NCVER Ltd, 1998.

CIA World Fact Book, 2005. The centre for South East European studies. Retrieved on May 15, 2007, from http://www.csees.net/?page=country_section&country_id=8&sec=4

Cerovic-Kovac, Tunde., Leutloff, Caroline., & Pichl, Elmar, 2000. *Education and media in Southeast Europe: Country report on education*. Retrieved on June 18, 2007, from http://www.gewi.uni-graz.at/csbsc/country_reports/Education_Kosovo.htm

Creswell, W. John. *Qualitative inquiry and research design: choosing among five traditions*. USA: SAGE Publications, 1998.

Donaldson. F. Joe, Flannery, Daniele. & Ross-Gordon, Jovita. "A triangulated study comparing adult college students' perceptions of effective teaching with those of traditional student continuing higher education". *Review* 57, No 3, Fall 1993:147-165.

ECIKS/ Ministry of Trade and Industry of Kosovo. Retrieved on June 14, 2007, from http://www.eciks-org/english/invest.php?action=total_invest&main_id=13

Elias, L. John., & Merriam, B. Sharan. *Philosophical foundations of adult education* (3rd ed.). Florida: Krieger Publishing Company, 2005.

Employment and skills observatory of Kosova. *Mainstreaming with Europe: an adult learning strategy for Kosovo (2005-2015)*, 2004. Website: www.etf.eu.int

Gartenschlaeger, Uwe. & Hinzen, Heribert. *Prospects and trends in adult education: A selection of contemporary writing on project work*. Bonn: The Institute For International Cooperation of the German Adult Education Association, 2001.

Gouvernement du Quebec. *Government policy on adult education and continuing education and training*, 2002: ISBN 2-550-39084-9

Gouvernement du Quebec. *Action plan for adult education and continuing education and training*,2000: ISBN 2-550- 39085-7

IIZ/DVV (2004). *Mediterranean conference on lifelong learning declaration*. Retrieved on June 24, 2007, from http://www.iiz-dvv.de/englisch?Publikationen/Ewb_ausgaben/61_2004/eng_declaration2.h

Knowles, Malcolm. *Self-directed learning: A guide for learners and teachers*. New York: Cambridge Book Co.,1988.

Krajnc,Ana.& Licen,Nives. *Adult education in Slovenia*. Bonn: The Institute for International Cooperation of the German Adult Education Association, 2002.

Lankard, A.Bettina. "New ways of learning in the workplace". ERIC Digest. Retrieved On May 27, 2007, from <http://www.ericdigest.org/1996-2/work.html>.

Merriam, Sharan. & Caffarella, Rosemary. *Learning in adulthood: A comprehensive guide* (2nd ed.). San Francisco: Jossey-Bass, 1998.

Ministry of Education, Science and Technology.(n.d.). Retrieved on May 28, 2007, from (http://www.see-educoop.net/education_in/pdf/budget2002d-yug-kos-enl-t01.pdf)

OECD (1996). *The Knowledge-based economy*. Retrieved on June 18, 2007, from <http://www.oecd.org/dataoecd/51/8/1913021/pdf>

Owens, G.Robert. *Organizational behavior in education: Adaptive leadership and school reform* (8th ed.). USA: Pearson education, Inc.,2004.

Pantaleev, Tzako. *Macedonia adult and continuing education*. Bonn: The Institute for International Cooperation of the German Adult Education Association, 2003.

Provisional Institutions of Self Government- Assembly of Kosovo, 2001. *Law for adult education and training*. Retrieved on April 2007, from

http://www.see-educoop.net/education_in/pdf/budget2002d-yug-kos-enl-t01.pdf

Selman, Gordon., Cooke, Michael., Selman, Mark.,& Dampier, Paul. *The foundations of adult education* (2nd ed.). Toronto: Thompson Educational Publishing, Inc.,1998.

United Nations Development Programme, 2004. *Human development report Kosovo 2004: The rise of the citizen: challenges and choices*; 2004: 1-103.

Statistical Office of Kosovo. *Statistics on education in Kosovo, 2001*. Retrieved on May 15, 2007 from http://www.ks-gov.net/esk/publications/edu_2001.htm

Valencic,Polona. & Vilfan, Eva. *“Slovenian experience with certificates from Serbia and Kosovo”*(Fall 1999). Retrieved on June 18, 2007, from <http://www.aic.lv/ace/WP/Refugees/slovenia.htm>

Watkins, Karen. & Marsick, Victoria. (1992). *“Building the learning organization: A new role for human resource developers”*. *Studies in continuing education*, 1992:Vol.14 No 2, 29-115.

Zuboff, Shoshana. *In the age of the smart machine: The future of work and power*. New York: Basic Books, 1988.